



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES**

V E N D I M

Nr52, datë 03.08.2018

PËR

**“MIRATIMIN E DOKUMENTIT “RREGULLORE E BRENDSHME PËR HETIMIN
ADMINISTRATIV TË SINJALIZIMIT, MBROJTJEN E KONFIDENCIALITETIT
DHE PËR MBROJTJEN NGA HAKMARRJA ””**

Këshilli Drejtues (**KD**) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (**AKEP**), i përbërë nga:

1. Z. Ilir	Zela	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Edlira	Dvorani	Anëtar
4. Znj. Ketrin	Topçiu	Anëtar
5. Znj. Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare e Këshillit Drejtues Znj. Sara Reçi, në mbledhjen e datës 03.08.2018, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin Nr. 9918 datë 19.05.2008 “*Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, Ligjin Nr. 8480, datë 27.05.1999 “*Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike*”, dhe Rregullores së Brendshme të Funksionimit të Këshillit Drejtues të AKEP, miratuar me Vendimin Nr.7 datë 16.02.2018 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

**“MIRATIMIN E DOKUMENTIT “RREGULLORE E BRENDSHME PËR HETIMIN
ADMINISTRATIV TË SINJALIZIMIT, MBROJTJEN E KONFIDENCIALITETIT
DHE PËR MBROJTJEN NGA HAKMARRJA ””.**

BAZA LIGJORE:

1. Ligji Nr. 9918 datë 19.05.2008 “*Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë*”, (**ligji 9918/2008**);
2. Ligji nr. 60/2016, “*Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve*” (**ligji 60/2016**);

3. Ligji 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (*ligji 44/2015*);
4. Vendim i Këshillit të Ministrave nr.816, datë 16.11.2016, “Për Strukturën, Kriteret e Përzgjedhjes dhe Marrëdhëniet e Punës së Punonjësve të Njesisë Përgjegjëse në Autoritetet Publike, në zbatim të Ligjit nr. 60/2016, “Për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve”;
5. Rregullore e Brendshme e Funkionimit të Këshillit Drejtues të AKEP, miratuar me Vendimin Nr.7 datë 16.02.2018 të Këshillit Drejtues të AKEP.

KËSHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor i përbërë si më poshtë:

- Relacioni Shpjegues i projekt vendimit;
- Dokumenti “*Projekt Rregullore e Brendshme për Hetimin Administrativ të Sinjalizimit, Mbrojtjen e Konfidencialitetit dhe për Mbrojtjen nga Hakmarrja*”;
- Projektvendim i KD i formatuar dhe arsyetuar;

VËREN:

Me miratimin e Vendimit të Kuvëndit të Republikës së Shqipërisë Nr.56/2018, datë 29.03.2018 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”, si dhe në referim të pikës 1 të nenit 10 të ligjit 60/2016, pranë AKEP ka lindur detyrimi për të caktuar strukturën përgjegjëse për rregjistrimin, hetimin administrativ dhe shqyrtimin e sinjalizimeve të brendshme.

Në këtë kontekst, bazuar në pikën 10 të nenit 13 dhe pikën 8 të nenit 19 të ligjit 60/2016, çdo autoritet publik do të duhet të miratojnë rregullore të brendshme të posaçme për procedurën e shqyrtimit të hetimit administrativ të sinjalizimit dhe mekanizmat e mbrojtjes së konfidencialitetit, dhe mbrojtjes nga hakmarrja.

Në këtë kuadër, hartimi dhe miratimi i Rregullores së Brendshme “*Për hetimin administrativ të sinjalizimit, mbrojtjen e konfidencialitetit dhe për mbrojtjen nga hakmarrja*”, si akt nënligjor dalë në zbatim të Ligjit nr.60/2016, “Për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve”, i shërben rritjes së efektshmërisë ndaj praktikave korruptive në Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare. Ky ligj, konsiderohet si një mekanizëm i rëndësishëm antikorrupsion, për shkak se ndihmon të gjithë punonjësit e autoritetit administrativ, si dhe të gjithë ata që kanë marrëdhënie kontraktuale të caktuara me një institucion publik, që të sinjalizojnë veprimet korruptive me të cilat ndeshen.

Misioni i ligjit është përmirësimi i aftësisë së subjekteve respektive për të luftuar korrupsionin dhe forma të tjera të sjelljes së paligjshme. Në këtë kontekst, mbetet e nevojshme miratimi i akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji me qëllim përcaktimin e procedurave përkatëse për

zhvillimin e hetimit administrativ të sinjalizimit dhe mekanizmat e mbrojtjes së konfidencialitetit, si dhe për procedurën e shqyrtimit të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja.

Zbatimi i legjislacionit për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesit në AKEP nëpërmjet kësaj rregullore të brendshme, ka si qëllim parandalimin e ndikimeve të paligjshme në kryerjen e detyrave apo marrjen e vendimeve, shpërdorimin e të ardhurave të buxhetit të AKEP, përfitimin e paligjshëm, mitdhënien apo mitmarrjen, si dhe çdo akt tjetër të ngjashëm.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në pikën 1 të nenit 114, të ligjit nr. 9918, “Për Komunikimet Elektronike ne Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 13, dhe nenin 19 të ligjit 60/2016, “Për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve”, Këshilli Drejtues i AKEP;

VENDOS:

1. Të miratojë dokumentin:

a) *“Rregullore e Brendshme “Për hetimin administrativ të sinjalizimit, për mbrojtjen e konfidencialitetit dhe për mbrojtjen nga hakmarrja”.*

2. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit www.akep.al.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

KRYETARI

Ilir ZELA

ANËTARË:

1. **Z. Alban KARAPICI**
2. **Znj. Edlira DVORANI**
3. **Znj. Ketrin TOPÇIU**
4. **Znj. Klarina ALLUSHI**